



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.03-240**  
**12.07.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14 , 101/14, 132/14, 142/16, 132/17 , 168/18 , 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 100 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës ( Teksti i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me ark.nr.10- 2551/1, datë 20.06.2023 dhe Konkluzionin ark. nr. 02-2749/5, datë 12.07.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 22-të mbajtur më 11.07.2023, miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 100 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), në mënyrë që në shërbimin programor të datës 06.06.2023, i transmetuar në nivel shtetëror, SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup në disa orë reale e ka tejkaluar limitin (kufirin) reklamues prej 12 minutash për një orë reale.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar për bllok reklamimi, orë reale nga – deri në,periudha e transmetimit (fillimi, përfundimi dhe kohëzgjatja), kufiri i tejkaluar për reklamim dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr.10-2551/1 datë 20.06.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele me kërkesë, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave të Ligjit të cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe

akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve përcaktuar me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 100 paragrafi (1) të LSHMAAV, kohëzgjatja e spoteve reklamuese dhe të spoteve teleshoping në programet e transmetuesve, përveç shërbimit publik të transmetimit, nuk mund të tejkalojë limitin e lejuar prej 12 minuta në një orë reale.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 20 qershor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor në radio të SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup, transmetuar më 06.06.2023, në nivel shtetëror, nga ku u konstatua shkelja e nenit 100 paragrafi (1) nga LSHMAAV. Gjegjësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në shërbimin programor të datës 06.06.2023, SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup në disa orë reale ka tejkaluar kufirin (limitin) e lejuar prej 12 minutash reklamim në një orë reale.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar për bllok reklamash, orë reale nga – deri në, periudha e transmetimit (fillimi, përfundimi dhe kohëzgjatja), kufiri i tejkaluar për reklamim dhe përshkrim në Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore me ark.nr.10-2551/1 datë 20.06.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafit (3) të LSHMAAV Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup me datë 23.06.2023, dërgoi Shkresë me ark.nr.10-2551/2 datë 23.06.2023, me të cilën ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative me ark.nr. 10-2551/1 datë 20.06.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e transmetuesit më 27.06.2023. Në afatin e paraparë, SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave nga Ligji. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 11.07.2023, e shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konstatoi se ndaj SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 100 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me ark.nr.10-2551/1 datë 20.06.2023, dhe Konkluzionin ark.nr.02-2749/5, datë 12.07.2023, për shkak të konstatimit të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 11.07.2023, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR METROPOLIS RADIO SHPK Shkup dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

#### **Shtojca (1):**

1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programoret ark.nr.10-2551/1 datë 20.06.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.